



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.11/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar Dastan Kiqina, Blerina Kiqina, dhe Albin Kiqina, nga Gjermania, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga Dastan Kiqina, Blerina Kiqina, dhe Albin Kiqina, nga Gjermania, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën **23.08.2021** PZAP-i ka pranuar një apel nga Dastan Kiqina, Blerina Kiqina, dhe Albin Kiqina, nga Gjermania, në të cilën pretendohet se i plotëson kriteret për votim jashtë Kosovës.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur KQZ, me të cilën ka theksuar se ka dërguar vetëm dokumentin për regjistrim duke mos dëshmuar as kriterin e identitetit dhe as kriterin ligjor për tu përfshirë si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës. Aplikacionin e ka dorëzuar me datë 19.08.2021.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesit i apelit gjatë aplikimit të tyre për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i kanë plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “*çdo person ka të drejt për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës*”, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil*”. Në rastin konkret parashtruesit e apelit nuk kanë bashkangjitur me ankesë asnjë dokument valid të Republikës së Kosovës që do të dëshmonte se të njëjtit i plotësojnë kriteret për votim jashtë Kosovës.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 11/2021 më datën 25.08.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.